

Rreth projektit

Ky aplikacion është përgatitur në kuadër të projektit “Evropa ime”, zbatuar nga Qendra Europiane dhe mbështetur nga Fondacioni Konrad Adenauer, Zyra për Shqipërinë. Qëllimi i këtij aplikacioni synon të rrisë ndërgjegjësimin midis të rinjve shqiptarë përmes një mënyre inovative në lidhje me Bashkimin Evropian, institucionet e tij kryesore dhe procesin e negociatave të Shqipërisë.

Pikëpamjet e shprehura në këtë aplikacion nuk shprehin qendrim zyrtar të Fondacionit Konrad Adenauer. Ato janë nën përgjegjësinë juridike dhe profesionale të autorëve.



Home



Historiku



Informacione



EVROPA
IME

PO BASHKIMI EVROPIAN
ÇFARË ËSHTË?



INSTITUCIONET E BASHKIMIT
EVROPIAN



SFIDAT NË RRUGËN E INTEGRIMIT
NË BE



NJË HAP LARG DREJT BE



SHQIPTAR DHE EVROPIAN



Home



Historiku



Informacione



ÇFARË ËSHTË BASHKIMI EVROPIAN?

Bashkimi Evropian (BE) është një bashkim njerëzish, idesh dhe vlerash. BE është një organizatë ndërkombëtare me status të veçantë, ku shtetet anëtare të saj përcaktojnë hapësirën dhe kompetencat e BE-së për të vepruar.

Në 1952 BE-ja nisi si një organizatë me qëllim politikash ekonomike të përbashkëta mes 6 shteteve. Më pas ajo u zgjerua me shtete të tjera dhe bashkëpunimi ekonomik përfshiu dhe fushat politike.

Aktualisht Aktualisht Aktualisht BE-ja është e përbërë nga 27 shtete anëtare, pas largimit të Britanisë së Madhe. Fushat në të cilat Bashkimi Evropian mund të veprojë, duke miratuar ligje apo hartuar politika, përcaktohen në bashkëpunim me shtetet anëtare të tij. Shtetet anëtare kanë hequr dorë nga ushtrimi i disa detyrave dhe të drejtave në disa fusha specifike, duke ja kaluar këto “të drejta” BE-së.



Home



Historiku



Informacione



ÇFARË ËSHTË BASHKIMI EVROPIAN?

VALËT E ZGJERIMIT TË BASHKIMIT EVROPIAN:

- 1952 - Themelimi i Komunitetit të Hekurit dhe Çelikut;
- 1958 - Komuniteti Ekonomik Evropian dhe Komuniteti Evropian i Energjisë dhe Atomiumit;
- 1993 - Traktati i Mاستrihtit zgjeroi kompetencat e BE-së duke i vendosur në tre shtylla kryesore;
- 1997 - Traktati i Amsterdamit, përfshiu në BE Marrëveshjen Shengen;
- 2001 - Traktati i Nisës zgjeroi më tej hapësirën e veprimit të Komisionit Evropian;
- 2009 - Traktati i Lisbonës bëri ndarjen e kompetencave.

HAPËSIRA E VEPRIMIT TË BE-SË

Hapësira e veprimit të BE-së ndahet në:

1. Kompetenca ekskluzive - Fushat e veprimit ku vendos dhe ushtron politikë-bërjen vetëm BE-ja. Këtu përfshihen doganat, rregullat e konkurrencës për tregun e përbashkët evropian, politikën e përbashkët tregtare, ruajtjen e burimeve detare dhe politikën e përbashkët të peshkimit, si edhe politikën e përbashkët monetare për shtetet e eurozonës.

2. Kompetencat e ndara me shtetet anëtare - Fushat ku BE ndërmerri politika së bashku me shtetet anëtare. Këtu përfshihen tregu i brendshëm Evropian; politikat sociale; politikat ekonomike dhe sociale të kohezionit; mjedisi; mbrojtja e konsumatorit; transporti; energjia; bujqësia dhe peshkimi; çështjet e sigurisë së shëndetit; dhe punët e brendshme që lidhen me drejtësinë dhe sigurinë.

3. Kompetencat mbështetëse për shtetet anëtare - Fushat ku BE vepron vetëm në mbështetje të shteteve anëtare të saj, nëse këto të fundit nuk mund të arrijnë rezultatet e pritshme duke vepruar vetë. Këtu përfshihen, mbrojtja e shëndetit të njerëzve; industria; kultura; turizmi; edukimi, rinia dhe sportet; mbrojtja e qytetarëve dhe bashkëpunimi administrativ.



Home



Historiku



Informacione

Komisioni Evropian (1958) është organi ekzekutiv i BE. Ai përbëhet nga 27 komisionerë ku, çdo shtet anëtar përfaqësohet nga një komisioner, i propozuar nga Këshilli dhe i miratuar nga Parlamenti Evropian (PE). Komisioni Evropian kryesohet nga Presidenti, që zgjidhet nga PE me mandat 5 vjeçar. Komisionerët nuk përfaqësojnë pikëpamjet e shteteve të tyre të origjinës, por interesin e përbashkët të BE. Çdo anëtar i Komisionit përgjigjet për një fushë të caktuar, si psh: ekonomia, tregëtia, energjia, etj.

Funksionet e Komisionit:

- 1. Menaxhimi i buxhetit** - Menaxhon dhe harton politikat dhe buxhetin e BE-së dhe sigurohet që shtetet anëtare të zbatojnë legjislacionin e BE.
- 2. Propozimi i ligjeve të reja** - Propozon ligje dhe programe të reja, në interes të BE-së. Përpara hartimit së një propozimi, Komisioni merr mendimin e parlamenteve kombëtare, qeverive, grupeve të interesit dhe ekspertëve si dhe të publikut në tërësi. Propozimet e Komisionit shqyrtohen nga PE dhe Këshilli.
- 3. Zbatimi i ligjit të BE** *(në bashkëpunim me Gjykatën e Drejtësisë)* - Nëse një shtet anëtar nuk zbaton rregullat dhe Direktivat e BE-së atëherë Komisioni i drejton letër zyrtare me qëllim marrjen e masave të domosdoshme nga ana e shtetit që ka kryer shkeljen.



2. Propozimi i ligjeve të reja - Propozon ligje dhe programe të reja, në interes të BE-së. Përpara hartimit së një propozimi, Komisioni merr mendimin e parlamenteve kombëtare, qeverive, grupeve të interesit dhe ekspertëve si dhe të publikut në tërësi. Propozimet e Komisionit shqyrtohen nga PE dhe Këshilli.

3. Zbatimi i ligjit të BE *(në bashkëpunim me Gjykatën e Drejtësisë)* - Nëse një shtet anëtar nuk zbaton rregullat dhe Direktivat e BE-së atëherë Komisioni i drejton letër zyrtare me qëllim marrjen e masave të domosdoshme nga ana e shtetit që ka kryer shkeljen.

Selia - Bruksel

Presidente e Komisionit European - Ursula von der Leyen

PARLAMENTI EVROPIAN

KËSHILLI EVROPIAN

KËSHILLI I BASHKIMIT EVROPIAN

SHËRBIMI I JASHTËM I BE-SË

GJYKATA E DREJTËSISË E BASHKIMIT EVROPIAN

BANKA QENDRORE E BE-SË



Home



Historiku



Informacione

PARLAMENTI EVROPIAN

Parlamenti Evropian (1952) është zëri i qytetarëve të BE-së. 705 anëtarët e tij përfaqësojnë qytetarët e 27 shteteve. Euro-deputetët zgjidhen drejtpërdrejt nga qytetarët çdo 5 vjet. Zgjedhjet e ardhshme për Parlamentin do të mbahen pranverën e vitit 2024. Numri i anëtarëve përfaqësues të çdo shteti zgjidhjet në bazë të popullsisë së shtetit p.sh., Gjermania 96 eurodeputetë pasi ka 83.02 milionë banorë, ndërsa Malta ka 6 eurodeputetë pasi ka 493,559 banorë. Anëtarët e PE ndahen në grupe pune sipas bindjeve politike dhe jo në bazë të shtetësisë së tyre. Një grup politik përbëhet nga 25 anëtarë me përfaqësues nga të paktën $\frac{1}{4}$ e shteteve të BE. Aktualisht PE përbëhet nga 8 grupe. Parlamenti merr vendime mbi **legjislacionin** në bashkëpunim me Këshillin dhe nëse ato nuk bien dakord së bashku, ligji nuk miratohet. Ndër funksionet e Parlamentit mund të përmendim dhe zgjedhjen e Presidentit dhe anëtarëve të Komisionit Evropian dhe miratimin e buxhetit të BE.

Selia - Strasburg, Brkusel, Luksemburg

*President i Parlamentit Evropian - David-Maria
Sassoli*

KËSHILLI EVROPIAN

Këshilli Evropian (1974) fillimisht ka zhvilluar veprimtarinë e tij si një forum ku diskutonin liderët e shteteve anëtare të Evropës. Me hyrjen në fuqi të Traktatit të Lisbonës, Këshilli Evropian u bë zyrtarisht një nga institucionet e BE-së. Këshilli bën bashkë presidentët ose kryeministrat e vendeve të BE-së. Mblidhet të paktën 4 herë në vit dhe këto mbledhje quhen ndryshe “Samite Evropiane”. Këshilli Evropian vendos **prioritetet kryesore** dhe **direktivat e përgjithshme politike** për BE. Ai drejtohet nga Presidenti, që zgjidhet me një mandat 2.5 vjeçar. Presidenca e Këshillit të BE ndërrohet me rotacion çdo 6 muaj dhe kryesohet nga qeveria e një shteti anëtar.

Selia - Bruksel

*President i Këshillit Evropian - Charles Michel
(Kryeministri belg)*

Presidenca e radhës 2020 – Gjermania

KËSHILLI I BASHKIMIT EVROPIAN

Këshilli i Bashkimit Evropian ndryshe i njohur si Këshilli i Ministrave është organi kryesor vendimmarrës i BE. Ai përfaqëson shtetet anëtare dhe në takimet e tij merr pjesë një ministër nga secila prej qeverive të shteteve anëtare në varësi të natyrës së çështjeve, që do të diskutohen në takim. Çdo ministër i Këshillit është përgjegjës ndaj Parlamentit të vendit të tij si dhe ndaj qytetareve, duke garantuar kështu legjitimitetin e vendimeve të Këshillit.

Funksionet e Këshillit:

1. Miraton legjislacionin e BE-së;
2. Bashkërendimi i politikave ekonomike;
3. Nënshkrimi i marrëveshjeve ndërkombëtare në emër të BE, me shtete ose organizata ndërkombëtare;
4. Miraton buxhetin e BE-së së bashku me Parlamentin Evropian;
5. Përmirësimi i Politikave të Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët të BE-së;
6. Koordinon bashkëpunimin mes gjykatave dhe forcave të rendit të shteteve për çështjet penale.

SHËRBIMI I JASHTËM I BE-SË

Shërbimi i Jashtëm i BE-së (2011) i njohur ndryshe si shërbimi diplomatik përfaqëson organizatën dhe qytetarët e saj në të gjithë botën. Ky organ përbëhet nga nëpunës të BE, nëpunës dhe diplomatë të shteteve anëtare, si edhe nëpunës nga e gjithë bota si shërbime delegacionesh si p.sh., Delegacioni i BE në Shqipëri. Funkzioni kryesor i këtij organi është të **ndërtojë dhe përfaqësojë politikën e jashtme të BE-së** në të gjitha kontinentet për çështje si: të drejtat e njeriut, migrimi, zhvillimi i demokracisë, çështjet e sigurisë apo edhe çështjet ushtarake. Në krye të Shërbimit të Jashtëm qëndron Përfaqësuesi/ja e lartë që mban edhe titullin e Zv. Presidentit/es të Komisionit Evropian.

Selia - Bruksel

Përfaqësues i BE për Politikën e Jashtme dhe Sigurinë - Josep Borrell

GJYKATA E DREJTËSISË E BASHKIMIT EVROPIAN

Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Evropian (1952) është Gjykata më e Lartë e BE-së. Ajo vepron si gjykatë ndërkombëtare dhe si gjykatë e brendshme e shteteve anëtare. Ajo **garanton interpretimin dhe zbatimin** në mënyrë uniforme në të gjitha shtetet anëtare **të së drejtës së BE-së**. GJDBE përbëhet nga 27 anëtarë (gjyqtarë) dhe 11 avokatë të përgjithshëm, të cilët kanë për detyrë të japin opinione ligjore për çështjet që shtrohen për zgjidhje para gjykatës. Mendimet e tyre jepen publikisht. GJDBE funksionon si në rastet kur një gjykatë vendase ngre diskutime për interpretimin e ligjeve të BE-së, ashtu dhe kur një shtet anëtar i BE-së nuk i zbaton ligjet në mënyrë të rregullt.

Selia - Luksemburg

Kryetari - Koen Lenaerts

BANKA QENDRORE E BE-SË

Banka Qendrore e BE-së (1998) është institucioni që ka në ngarkim politikën monetare për 19 vendet e Bashkimit Evropian, që përdorin monedhën euro dhe formojnë të ashtuquajturën “Eurozonë”. Qëllimi i Bankës është **garantimi i stabilitetit të çmimeve në eurozonë.**

Funksionet e Bankës Qendrore:

1. Përcaktimi dhe zbatimi i politikës monetare në shtetet e Bashkimit Monetar Evropian (BME);
2. Administrimi i rezervave valutore zyrtare;
3. Mbështetja e sistemit të pagesave; dhe
4. Zbatimi i transaksioneve valutore.

BQE ka gjithashtu të drejtën ekskluzive për emetimin e bankënotave euro në BME. Sipas Marrëveshjes së Mاستrihtit, BQE është e pavarur nga çdo ndikim politik. Banka disponon buxhet prej 11 miliardë eurosh, i cili jepet nga bankat qendrore të 19 vendeve të eurozonës të BE-së.

Selia - Frankfurt

*Guvernatorja e Bankës Qendrore Evropiane -
Christine Lagarde*



Home



Historiku



Informacione



**INSTRUMENTAT E BASHKIMIT
EVROPIAN PËR INTEGRIMIN E
BALLKANIT PERËNDIMOR**

**BASHKËPUNIMI RAJONAL ME SFIDA TË
PËRBASHKËTA INTEGRIMI**

**SHQIPËRIA DHE BE NË 11 VITET E
FUNDIT**

DETYRAT E SHTËPISË PËR NË BE



Home



Historiku



Informacione

INSTRUMENTA POLITIKË

Pakti i Stabilitetit: Bashkëpunimi BE - Ballkan u thellua si fillim në vitin 1999, në kohën e luftës në Kosovë. Për herë të parë, Bashkimi Evropian ndërtoi një instrument për vendosjen e lidhjeve të ngushta me Ballkanin nëpërmjet Paktit të Stabilitetit, i cili merrej me çështjen e sigurisë edhe stabilitetit në Ballkan. Për herë të parë rajoni u pa si pjesë e Evropës me mundësi për anëtarësim.

Procesi i Stabilizim Asociimit (PSA): Më shumë sesa një instrument është një politikë, i cili ka nisur në 1999 dhe vendosi marrëdhënie mes BE-së dhe secilit prej shteteve të rajonit të Ballkanit. Procesi i Stabilizim Asociimit përmban hapa dhe kushte për përmirësimin e situatës politike të shtetit drejt demokracisë dhe shtetit të së drejtës, si edhe vendos lidhjet e para mes ekonomisë së shtetit dhe tregut të përbashkët Evropian. Qeveria e çdo shteti është përgjegjëse kryesore për mirëfunksionimin e procesit në identifikimin e objektivave të përbashkëta me BE-në dhe pasjen e marrëdhënieve të mira fqinjësore në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Procesi i Stabilizim Asociimit mbështet nga ana financiare nga fondet IPA dhe vazhdon derisa vendi bëhet anëtar i BE-së.

Marrëveshja e Stabilizim Asociimit (MSA)

është instrumenti kryesor që rregullon marrëdhëniet mes Bashkimit Evropian dhe vendeve që duan të anëtarësohen. Kjo Marrëveshje është në zbatim të Procesit të Stabilizim Asociimit dhe synon së pari të zhvillojë një treg të lirë mes BE-së dhe shtetit që firmoset marrëveshja. Pasi ky rregullim për tregtinë e lirë të mallrave është bërë dhe mallrat vendase shiten në BE dhe ato të BE-së brenda vendit, Marrëveshja identifikon objektiva politike dhe ekonomike të përbashkëta.

Progres raportet janë një instrument kyç i marrëdhënieve BE - shteti që kërkon të anëtarësohet. Këto raporte masin punën dhe përmirësimin e vendeve sipas tre kriterëve kryesore, të njohura ndryshe si Kriteret e Kopenhagenit: (i) kriteri politik ku vëmendje i kushtohet forcimit të shtetit të së drejtës, gjykatave të pavarura, lirisë së medias, respektimit të të drejtave të njeriut etj. (ii) kriteri ekonomik, ku raportohet mbi gjendjen e zhvillimit të tregut të lirë mes BE-së dhe shtetit për të cilin hartohet raporti, zhvillimit të konkurrencës në treg, gjendja dhe niveli i papunësisë, rritja e standardeve të produkteve etj. (iii) kriteri ligjor: ky kriter ka të bëjë me aftësinë që ka shteti që kërkon të anëtarësohet të përthithë dhe të marrë ligjet dhe rregulloret e Bashkimit Evropian në legjisllacionin e brendshëm. Kriteri ligjor është kusht i fortë dhe strikt që tregon sesa i gatshëm është vendi të qeveriset sipas ligjeve



të BE-së dhe sesa gati është administrata e atij vendi t'i zbatojë në punën e përditshme këto ligje. Këto përbëjnë kushtet kryesore të anëtarësimit.

Dialogjet bilaterale janë një formë tjetër e marrëdhënieve BE dhe shteteve të rajonit. Këto marrëdhënie janë mes Bashkimit Evropian dhe një shteti të rajonit të Ballkanit Perëndimor. Dialogjet marrin formën e takimeve mes kryetarëve të institucioneve të BE-së ose shteteve anëtare të BE-së dhe kryeministrit ose ministrave të vendit që kërkon të anëtarësohet.

Strategjitë e zgjerimit janë një instrument tjetër politik i Bashkimit Evropian që hartohet çdo vit nga Komisioni Evropian. Strategjia përcakton linjën dhe objektivat kryesore të BE-së për vendet që duan të anëtarësohen. Këto strategji tregojnë gadishmërinë dhe nivelin e optimizmit të BE-së për të ndërmarrë politika zgjerimi në shtete të reja. Strategjitë kanë dy pjesë kryesore: politike dhe ekonomike e në fund përmbajnë konkluzione dhe përmbledhje të raporteve për secilin shtet. Vihet re që Komisioni i ka dhënë më shumë rëndësi kriterit politik për shtetin demokratik dhe të drejtat e njeriut, duke i vendosur ato në pjesën e parë të raportit.

Negociatat janë instrument politik i marrëdhënieve BE - shtet kandidat. Në këtë fazë shteti që kërkon të anëtarësohet ka bërë përmirësime të vazhdueshme e të dukshme,



Home



Historiku



Informacione

tjetër politik i Bashkimit Evropian që hartohet çdo vit nga Komisioni Evropian. Strategjia përcakton linjën dhe objektivat kryesore të BE-së për vendet që duan të anëtarësohen. Këto strategji tregojnë gadishmërinë dhe nivelin e optimizimit të BE-së për të ndërmarrë politika zgjerimi në shtete të reja. Strategjitë kanë dy pjesë kryesore: politike dhe ekonomike e në fund përmbajnë konkluzione dhe përmbledhje të raporteve për secilin shtet. Vihet re që Komisioni i ka dhënë më shumë rëndësi kriterit politik për shtetin demokratik dhe të drejtat e njeriut, duke i vendosur ato në pjesën e parë të raportit.

Negociatat janë instrument politik i marrëdhënieve BE - shtet kandidat. Në këtë fazë shteti që kërkon të anëtarësohet ka bërë përmirësime të vazhdueshme e të dukshme, duke marrë statusin vend kandidat për në BE dhe duke hapur negociatat për anëtarësim

INSTRUMENTA EKONOMIKE

BASHKËPUNIMI RAJONAL ME SFIDA TË PËRBASHKËTA INTEGRIMI

SHQIPËRIA DHE BE NË 11 VITET E FUNDIT

DETYRAT E SHTËPISË PËR NË BE

MSA dhe Fondet IPA: MSA përcakton objektivat dhe politikat kryesore për ekonominë dhe mbështetet nga ana financiare nëpërmjet fondeve IPA. Këto fonde jepen nga Bashkimi Evropian për vendet para anëtarësimit në mënyrë që këto të kenë fonde për të bërë reformat dhe për të përmirësuar shërbimet. Këto fonde janë të ndara në dy kategori. Fonde për një shtet të caktuar dhe fondet ndërkufitare, të cilat financojnë projekte ndërlidhjeje në rajon si p.sh., rrugë, hidrocentrale etj.

Programet e Reformave Ekonomike (PRE)

janë instrumentat më të reja të integritimit në fushën ekonomike. Këto Programe janë raporte ekonomike që secili vend i Ballkanit Perëndimor i dërgon Komisionit Evropian për t'i shpjeguar gjendjen ekonomike të shtetit. Ato u aplikuan për herë të parë në vitin 2015 dhe do vazhdojnë të hartohen çdo vit deri në fazën e integritimit. Qëllimi i PRE është të identifikojë problemet e ekonomisë së secilit shtet në mënyrë që BE të hartojë politika ekonomike dhe të japë fonde për vendin, sipas nevojave të tij.

Marrëveshja e Tregtisë së Lirë në Evropën

Qendrore (CEFTA) është një instrument ekonomik dhe teknik mes BE-së dhe vendeve jo anëtare si për shembull vendet e rajonit të Ballkanit Perëndimor. CEFTA synon zhvillimin e një tregu të lirë nëpërmjet Marrëveshjeve të Tregut të Lirë me secilin shtet, qoftë ky shtet që kërkon të anëtarësohet në BE ose jo.



Home



Historiku



Informacione

BASHKËPUNIMI RAJONAL ME SFIDA TË PËRBASHKËTA INTEGRIMI

Ballkani Perëndimor karakterizohet nga sfida të përbashkëta në procesin e integritimit në BE. Këto vende kanë qenë pjesë e ish bllokut komunist, e për pasojë kanë mangësi në institucione të forta demokratike dhe ekonomi me treg të hapur e konkurrues.

Faktorët historikë e gjeografikë të njëjtë dhe konflikte me tipare identiteti, karakterizojnë 6 vendet e Ballkanit Perëndimor. Disa nga problemet kryesore të ngjashme në secilin vend të rajonit të Ballkanit Perëndimor që kërkon të anëtarësohet janë:

- Forcimi i demokracisë;
- Përmirësimi i respektimit të të drejtave të njeriut dhe të minoriteteve;
- Lufta kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar;
- Forcimi i institucioneve dhe administratës publike;
- Zhvillimi i gjykatave të pavarura e të drejta;
- Zhvillimi i një tregu të hapur;
- Rritja e konkurrencës së tregut dhe ekonomisë;
- Ulja e papunësisë;
- Rritja ekonomike;
- Zhvillimi i infrastrukturës së rrugëve dhe rrjetit energjistik;
- Përmirësimi i politikave për të rinjtë;
- Përmirësimi i cilësisë së edukimit dhe kërkimit shkencor;
- Ndërtimi i marrëdhënieve të mira me fqinjët dhe bashkëpunimi rajonal.



Home



Historiku




Informacione

BE-ja dhe Komisioni Evropian që nga 2014, nxisin fuqishëm vendet e rajonit të bashkëpunojnë në sfidat e përbashkëta. Bashkëpunimi dhe marrëdhëniet e mira fqinjësore përbëjnë një kusht thelbësor në Procesin e Stablizim Asociimit dhe në anëtarësimin e këtyre vendeve.

SHQIPËRIA DHE BE NË 11 VITET E FUNDIT

DETYRAT E SHTËPISË PËR NË BE



Home



Historiku



Informacione

SHQIPËRIA DHE BE NË 11 VITET E FUNDIT

Prill 2009 - Hyn në fuqi Marrëveshja e Stabilizim-Asocimit BE - Shqipëri.

Prill 2009 - Shqipëria paraqet kërkesën zyrtare për anëtarësim në Bashkimin Evropian.

Nëntor 2010 - BE miraton vendimin për liberalizimin e vizave me Shqipërinë.

Dhjetor 2010 - Hyrja në fuqi e liberalizimit të vizave për qytetarët shqiptarë që udhëtojnë në vendet e zonës Schengen.

Dhjetor 2011 - Plani i Punës për anëtarësimin e Shqipërisë në BE, plotësimi i rekomandimeve.

Tetor 2012 - Komisioni Evropian rekomandon dhënien e statusit të vendit kandidat për Shqipërinë.

Dhjetor 2013 - BE refuzon dhënien e statusit të vendit kandidat për Shqipërinë.

Qershor 2014 - Shqipëria merr statusin e vendit kandidat për anëtarësim në Bashkimin Evropian.

Prill 2018 - Rekomandim pa kushte për hapjen e negociatave me Shqipërinë.

Mars 2020 - Hapja e negociatave për Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut



Home



Historiku



Informacione

DETYRAT E SHTËPISË PËR NË BE

Nga 2014 kur Shqipëria mori statusin e vendit kandidat, i janë vendosur kushte për përmirësimin dhe funksionimin e shtetit demokratik me qëllim sigurimin e një jetë më të mirë qytetarëve të saj nga ana ekonomike. Këto kushte, shpesh janë quajtur si *detyra shtëpie*, të cilat vlerësohen nga Komisioni Evropian përmes raporteve vjetore për shtetet duke e mbështetur vlerësimin në 3 kriteret e Kopenhagenit. Këto raporte kanë shërbyer si busull për të përcaktuar fushat ku Shqipëria duhet të përmirësohet.

Pas rekomandimeve të Komisionit drejtuar Këshillit më 18 qershor 2019 për hapjen e negociatave për Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut dhe duke vijuar më tej me diskutimet për zgjerimin të bëra më tetor 2019, Këshilli ju rikthye dhe një herë kësaj çështjeje më 5 shkurt 2020 duke dalë me një sërë konkluzionesh për këto dy shtete.

Theksi u vendos tek mbështetja e BE-së për perspektivën evropiane të zgjerimit me anëtarësimin e shteteve të Ballkanit Perëndimor, duke u mbështetur në meritat e secilit shtet.

Pas miratimit të hapjes së negociatave, duhet të mbledhet Konferenca e Parë Ndërqeveritare.

Para mbledhjes së Konferencës së Parë Ndërqeveritare, **Shqipëria duhet:**

- Të miratojë plotësisht reformën zgjedhore në



Home



Historiku



Informacione

përputhje me rekomandimet e OSBE/ODHIR, duke siguruar transparencën financiare të partive politike dhe fushatave elektorale;

- Të sigurojë zbatimin e vazhdueshëm të reformës gjyqësore, duke përfshirë garantimin e funksionimit të Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë, duke marrë parasysh ekspertizën përkatëse ndërkombëtare, përfshirë opinionet e Komisionit të Venecias,
- Të përfundojë krijimin e strukturave të specializuara kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar.
- Të forcojë më tej luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, përmes bashkëpunimit me Shtetet Anëtare të BE-së dhe përmes planit të veprimit për të adresuar rekomandimet e Task Forcës së Veprimit Financiar.
- Të luftojë fenomenin e aplikimeve të pabazuara për azil dhe të sigurojë riatdhesimet;
- Të ndryshojë ligjin e mediave në përputhje me rekomandimet e Komisionit të Venecias.

Komisioni do të përgatisë një raport mbi këto çështje, përfshirë progresin në lidhje me përmbushjen e kriterëve të mësipërme, kur prezanton hapjen e negociatave.

Hapja e negociatave lidhet ngushtësisht me adresimin me sukses të prioriteteve kryesore:

- Nisja e proceseve penale kundër gjyqtarëve dhe prokurorëve, pasi kanë kaluar në sitën e vetingut;
- Nisja e proceseve kundër atyre që akuzohen për blerjen e votave;
- Lufta kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar në të gjitha nivelet duhet të tregojë rezultate, përfshi inicimin dhe përfundimin e proceseve të para kundër zyrtarëve të nivelit të lartë publik dhe politikanëve,
- Reformimi i administratës publike duhet të tregojë rezultate pozitive;
- Zbatimi i reformës së ligjit zgjedhor si dhe zbardhja e një vendimi të formës së prerë për ligjshmërinë e zgjedhjeve lokale të 30 qershorit 2019;
- Ecuria e mëtejshme në miratimin e legjislacionit dytësor lidhur me ligjin kuadër 2017 për mbrojtjen e pakicave kombëtare,
- Miratimin e ligjit për regjistrimin e popullsisë në përputhje me rekomandimet e Këshillit të Evropës;
- Përparimi i procesit të regjistrimit të pronave.

Më tej Komisioni do të vijojë të monitorojë progresin dhe pajtueshmërinë në të gjitha fushat që lidhen me hapjen e negociatave si dhe të kryejë dhe të përfundojë procesin e shqyrtimit analitik të acquis të BE-së me vendin tonë, duke filluar me grupimin e parë, atë të të drejtave themelore, konkretisht me kapitujt 23 dhe 24.



Home



Historiku



Informacione

NEGOCIATAT DHE KAPITUJT E NEGOCIMIT

Me qëllim që Shqipëria t'i bashkohet Bashkimit Evropian duhet të respektojë vlerat demokratike të tij dhe të angazhohet në promovimin e tyre. Përveç respektimit të vlerave, duhen përmbushur Kriteret e Kopenhagenit.

Hapja e negociatave për anëtarësimin në Bashkimin Evropian është një proces, në të cilin vendi kandidat merr përsipër të harmonizojë legjislacionin e brendshëm me rregullat evropiane në të gjitha fushat, si dhe ta zbatojë atë. Vendi kandidat duhet të pranojë Traktatet e Themelimit dhe të Funkcionimit të BE-së.

Palët pjesëmarrëse në negociata janë:

Vendi kandidat – i cili përfaqësohet nga Delegacioni Shtetëror për Negociatat;

Vendet anëtare – të cilat përfaqësohen nga Presidenca e Këshillit të Bashkimit Evropian.

Vendi kandidat nuk negocion legjislacionin (*acquis*) në vetvete, por **negocion afatet** si dhe **marrjen e masave për zbatimin e legjislacionit të BE**, në vendin kandidat.

Procesi i Skanimi (Screening) - Hapja formale e procesit të negociatave që ndiqet nga shqyrtimi analitik dhe vlerësimi i nivelit të harmonizimit të legjislacionit kombëtar me legjislacionin e BE-së. Qëllimi kryesor i screening është të përcaktojë



Home



Historiku



Informacione

ndryshimet mes legjislacionit kombëtar dhe atij të BE, për çdo kapitull. Ai është i organizuar në 2 faza:

- » **Shumëpalëshe**, ku legjislacioni i BE prezantohet nga Komisioni;
- » **Dypalëshe**, ku vendit kandidat i kërkohet të prezantojë shkallën e përafrimit me acquis;

Përgjatë këtij procesi, vendi kandidat duhet të jetë i gatshëm për të harmonizuar tërësisht legjislacionin e tij kombëtar me atë të BE, ose të përcaktojë fushat ku mund të kërkohet periudhë tranzitore për zbatimin e tyre. Kohëzgjatja e procesit screening varet nga përmbajtja e acquis së BE dhe varion nga një ditë deri në dy javë. Përgjithësisht, i gjithë procesi, për të 35 kapitujt e acquis zgjat përafërsisht një vit.

Pas këtij procesi, Komisioni Evropian prezanton një **Raport Përfundimtar** për secilin kapitull. Mbi bazat e këtij Raporti, vendet anëtare mund të vendosin nëse do të hapen negociatat për kapitullin në fjalë, ose do të ftojnë vendin kandidat që fillimisht të plotësojë të ashtuquajturat “masat për hapjen” ose “masat për mbylljen”, të njohura ndryshe si **benchmarks**. Masat nënkuptojnë kushtet që duhet të plotësohen nga vendi kandidat, me qëllim hapjen e negociatave për kapitujt e veçantë.

Me hapjen e negociatave për këto kapituj, fillon faza thelbësore e procesit të negociimit. Vendi kandidat përgatit **Pozicionin Negociues** për secilin kapitull. Subjekt i negociatave janë kushtet nën të cilat vendi kandidat do të miratojë dhe zbatojë acquis e BE-së, përfshi dhe periudhën tranzitore. Pasi është arritur



Home



Historiku



Informacione

marrëveshja ndërmjet BE dhe vendit kandidat dhe pasi janë plotësuar kushtet mbyllëse, kapitulli që është trajtuar konsiderohet përkohësisht i mbyllur.

Vendimi formal merret nga **KDN (Konferenca Dypalëshe Ndërqeveritare)** në nivel ministrash. Këto negociata mund të hapen sërish:

- Para miratimit të Traktatit të Anëtarësimit;
- Nëse përcaktohen masa të reja; ose
- Nëse vendi kandidat nuk i plotëson më masat përkatëse.

Në rastin kur të gjithë kapitujt janë mbyllur përkohësisht, Këshilli Evropian përcakton përfundimin e procesit të negociimit me vendin kandidat dhe rezultatet e negociatave përfshihen në masat e draftit të Traktatit të Anëtarësimit.

Traktati i Anëtarësimit nënshkruhet nga zyrtarët më të lartë të vendeve anëtare të BE dhe vendi kandidat, e më pas ratifikohet nga të gjitha vendet anëtare. Me nënshkrimin e tij, vendi kandidat ka të drejtë të marrë pjesë si vëzhgues aktiv në punimet e Këshillit të Evropës dhe Parlamentit Evropian. Vendi kandidat bëhet vend anëtar i BE me hyrjen në fuqi të Traktatit të Anëtarësimit, nëse është plotësuar kushti që procesi i ratifikimit ka përfunduar.

KAPITUJT NEGOCIUES: GRUPIMET



Home



Historiku



Informacione

NEGOCIATAT DHE KAPITUJT E NEGOCIMIT

KAPITUJT NEGOCIUES: GRUPIMET

Kapitujt negociues: Grupimet

1.Të Drejtat Themelore

Kapitulli 23 - Gjyqësori dhe të drejtat themelore

Kapitulli 24 - Drejtësia, liria dhe siguria

Kapitulli 5 - Prokurimi publik

Kapitulli 18 - Statistikat

Kapitulli 32 - Kontrolli financiar

2.Tregu i Brendshëm

Kapitulli 1 - Liria e lëvizjes së mallrave

Kapitulli 2 - Liria e lëvizjes së punëtorëve

Kapitulli 3 - E drejta e vendosjes & liria e ofrimit të shërbimeve

Kapitulli 4 - Liria e lëvizjes së kapitalit

Kapitulli 6 - E drejta e shoqërive

Kapitulli 7 - E drejta e pronësisë intelektuale

Kapitulli 8 - Politika e konkurrencës

Kapitulli 9 - Shërbime financiare

Kapitulli 28 - Mbrojtja e konsumatorit & shëndetit



Home



Historiku



Informacione

3.Konkurrenca dhe Rritja Gjit hëpërfshirëse

Kapitulli 10 - Shoqëria e informacionit & media

Kapitulli 16 -Tatimet

Kapitulli 17 - Politika ekonomike dhe monetare

Kapitulli 19 - Politikat sociale & punësimi

Kapitulli 20 - Ndërmarrjet & politikat industrial

Kapitulli 25 - Shkenca dhe kërkimi

Kapitulli 26 - Edukimi dhe kultura

Kapitulli 29 - Bashkimi doganor

4.Agjenda e Gjelbër dhe Lidhja e Qëndrueshme

Kapitulli 14 - Politika e transportit

Kapitulli 15 – Energjia

Kapitulli 21 - Rrjetet trans-europiane

Kapitulli 27 - Mjedisi

5.Burimet, Bujqësia dhe Kohezioni

Kapitulli 11 - Bujqësia & zhvillimi rural

Kapitulli 12 - Siguria ushqimore, Politikat Veterinare & Fitosanitare

Kapitulli 13 - Peshkimi

Kapitulli 22 - Politika rajonale & koordinimi i instrumenteve strukturore

Kapitulli 33 - Depozita financiare & buxhetore



Home



Historiku



Informacione

6.Marrëdhëniet e Jashtme

Kapitulli 30 - Marrëdhëniet e jashtme
Kapitulli 31 - Politika e jashtme, siguria & mbrojtja

* Këto dy kapituj do të trajtohen më vete

Kapitulli 34 - Institucionet
Kapitulli 35 - Çështjet e tjera

Kapitulli 23 dhe 24 janë dy kapitujt thelbësorë në përpjekjet e para aderimit dhe janë të një rëndësie të veçantë gjatë negociatave për antarësim. A jemi duke i bërë detyrat e shtëpisë për kapitullin 23 dhe 24?

Kapitulli 23. Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore

Krijimi i një gjyqësori të pavarur, të paanshëm dhe profesional përbën kusht kryesor të këtij kapitulli, i cili është thelbësor dhe ka një rëndësi të veçantë gjatë bisedimeve për anëtarësim. Shqipëria ka arritur rezultate konkrete në lidhje me zbatimin e reformave në kuadër të anëtarësimit në BE.

Sipas fushave të identifikuaara në konkluzionet e Këshillit, Shqipëria duhet të:

- Vijoje me procesin e rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve, me fokus përmbylljen e të gjitha dosjeve me përparësi;
- Krijojë strukturat e pavarura gjyqësore të parashikuara sipas reformës kushtetuese;
- Krijojë organe të specializuara, përkatësisht

Strukturën e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (SPAK), Byronë Kombëtare të Hetimit dhe Gjykatën.

Një prioritet po aq i rëndësishëm i qeverisë shqiptare është mbrojtja dhe respektimi i të drejtave themelore. Shqipëria ka ndërmarrë hapa konkretë në garantimin e lirive themelore të individit. Megjithatë, BE i ka kërkuar qeverisë shqiptare të marrë masa në përmirësimin e mekanizmave institucionalë për mbrojtjen e të miturve, viktimave të dhunës në familje, të përafrojtë legjislacionin ekzistues të drejtësisë për të mitur me atë ndërkombëtar, të konsolidojë praktikën kundër diskriminimit, si dhe të gjejë një zgjidhje të qëndrueshme strehimi për grupet në nevojë.

Kapitulli 24. Drejtësia, Liria dhe Siguria

Ky kapitull ka të bëjë me çështje të tilla si kontrolli i kufijve, vizave, emigracioni i jashtëm, azili, bashkëpunimi policor, lufta kundër krimin të organizuar dhe terrorizmit, bashkëpunimi në fushën e drogës, bashkëpunimi doganor dhe bashkëpunimi në parandalimin e krimin dhe veprave penale. Shtetet anëtare duhet të jenë të përgatitura, me qëllim që të zbatojnë siç duhet kuadrin në rritje të rregullave të përbashkëta. Drejtësia, Liria dhe Siguria janë disa nga fushat kyçe në të cilat Shqipëria, pavarësisht se ka njohur zhvillime, ende përballet dhe me sfida të shumta sidomos në fushën e krimin të organizuar dhe terrorizmit, i cili kërkon përmirësime në forcimin e strukturave të menaxhimit të kufijve dhe azilit. Kriza ekonomike e viteve të fundit që preku vendet e Evropës, pasoi me një numër të lartë të emigrantëve të kthyer, të

cilët përballen me mjaft sfida dhe sot e kësaj dite.

Referuar fushave të identifikuara në konkluzionet e Këshillit, Shqipëria duhet të:

- Forcojë gjurmimin e hetimeve, ndjekjeve penale dhe dënimeve përfundimtare në luftën kundër korrupsionit, përfshi zyrtarët e nivelit të lartë dhe luftën kundër krimit të organizuar

Autoritetet shqiptare kanë forcuar kapacitetet operacionale, koordinuese dhe monitoruese në luftën kundër korrupsionit, përmes punës së Task Forcës Anti-Korrupsion, krijimit të një drejtorie të posaçme kundër korrupsionit në Ministrinë e Drejtësisë dhe të një rrjeti të koordinatorëve antikorrupsion.

Gjithashtu, rezultate të mëtjshme të prekshme janë arritur edhe në luftën kundër krimit të organizuar.

Edhe, për rastet që lidhen me trafikimin e qenieve njerëzore, pastrimin e parave e prodhimin e trafikun e drogës ka pasur rritje të denoncimeve dhe po ashtu dënime përfundimtare. Në qershor 2019, EUROPOL hapi zyrën në Shqipëri duke caktuar Zyrtarin e parë të Ndërlidhjes në vendet e Ballkanit Perëndimor. Në janar të 2020 u miratua një ligj i posaçëm, që prezantoi masat parandaluese për forcimin e luftës kundër krimit të organizuar dhe terrorizmit, duke u përqëndruar në veçanti në sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurive të vendosura nga veprimtaria kriminale.



Home



Historiku



Informacione

Autoritetet shqiptare kanë forcuar kapacitetet operacionale, koordinuese dhe monitoruese në luftën kundër korrupsionit, përmes punës së Task Forcës Anti-Korrupsion, krijimit të një drejtorie të posaçme kundër korrupsionit në Ministrinë e Drejtësisë dhe të një rrjeti të koordinatorëve antikorrupsion.

Gjithashtu, rezultate të mëtjshme të prekshme janë arritur edhe në luftën kundër krimit të organizuar.

Edhe, për rastet që lidhen me trafikimin e qenieve njerëzore, pastrimin e parave e prodhimin e trafikun e drogës ka pasur rritje të denoncimeve dhe po ashtu dënime përfundimtare. Në qershor 2019, EUROPOL hapi zyrën në Shqipëri duke caktuar Zyrtarin e parë të Ndërlidhjes në vendet e Ballkanit Perëndimor. Në janar të 2020 u miratua një ligj i posaçëm, që prezantoi masat parandaluese për forcimin e luftës kundër krimit të organizuar dhe terrorizmit, duke u përqëndruar në veçanti në sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurive të vendosura nga veprimtaria kriminale.

Nisur nga progresi domethënës dhe përmbushjen e kushteve, sipas progres raportit të 2018, Komisioni rekomandoi në paketën e tij të zgjerimit 2019 që Këshilli të hapë negociatat e pranimit me Shqipërinë. Në përgjithësi, Shqipëria ka rritur përpjekjet dhe ka treguar rezultate të prekshme dhe të qëndrueshme në fushat kryesore. Si rrjedhojë, **më 26 mars 2020, Këshilli vendosi hapjen e negociatave me Shqipërinë.**



Home



Historiku



Informacione

KONTRIBUTI QYTETAR NË JETËN E PËRDITSHME NË PROCESIN E INTEGRIMIT

Qytetarët shqiptar, por edhe të çdo vendi që kërkon të anëtarësohet, janë hallka kryesore e shtyrjes përpara të procesit të integritimit. Anëtarësimi në Bashkimin Evropian, vjen me përfitime të mëdha, por edhe shumë detyra e përgjegjësi. Ndaj është e rëndësishme që ky proces të kuptohet nga qytetarët në mënyrë që gjithsecili të japë kontributin e tij/saj.

Nëpërmjet informimit dhe kuptimit të tërë procesit, qytetarët shqiptarë duhet të jenë të aftë të kuptojnë progresin e bërë nga qeveria dhe të ushtrojnë presion mbi qeverinë apo parlamentin që të përmirësojnë punën e tyre në fusha të caktuara.

Angazhimi qytetar shërben për vlerësimin e situatës të të drejtave të njeriut, ekonomisë, shërbimeve publike, mjedisit etj. Dokumente si Strategjitë, Raportet por edhe të tjera japin shumë informacione mbi mundësitë direkte që kanë individët për të përfituar nga përparimi i vendit në rrugën e integritimit. Për shembull vendet e Ballkanit Perëndimor mund të përfitojnë nga shkëmbimet Erasmus kudo në Evropë, mund të marrin fonde për punë kërkimore, nëse shteti ka status kandidat mund edhe të aplikojnë për praktika pune pranë institucioneve të BE-së etj.



Home



Historiku



Informacione

situatës të të drejtave të njeriut, ekonomisë, shërbimeve publike, mjedisit etj. Dokumente si Strategjitë, Raportet por edhe të tjera japin shumë informacione mbi mundësitë direkte që kanë individët për të përfituar nga përparimi i vendit në rrugën e integritit. Për shembull vendet e Ballkanit Perëndimor mund të përfitojnë nga shkëmbimet Erasmus kudo në Evropë, mund të marrin fonde për punë kërkimore, nëse shteti ka status kandidat mund edhe të aplikojnë për praktika pune pranë institucioneve të BE-së etj.

Kushtet dhe reformat e kërkuara nga BE-ja duhen zbatuar në themel, duke krijuar një kulturë tek njerëzit dhe në institucione mbi vlerat demokratike. Ato nuk duhen parë si një listë për t'u përmbushur pa bërë ndryshime në mënyrën e qeverisjes, në konceptimin e funksionimit të institucioneve si të pavarura nga njëra-tjetra, apo pa kultivuar edukimin qytetar që në shkolla për funksionimin e një shteti demokratik. Për këtë arsye, është e nevojshme që nxënësit, studentët dhe qytetarët e rinj e të vjetër të shoqërisë sonë, të kuptojnë mekanizmat e shtetit, i cili funksionon në shërbim të qytetarit dhe nevojave të tij.

Anëtarësimi në BE dhe procesi i integritit kuptohet pak nga qytetarët. Ky aplikacion shërben si një manual për të kuptuar më mirë BE-në, procesin e integritit dhe ecjen e Shqipërisë përgjatë kësaj rruge. Si qytetarë evropianë, edhe qytetarë shqiptarë, ne duhet të dimë më tepër e të jemi pjesë më aktive në përmirësimin e Shqipërisë drejt rrugës së integritit.



Home



Historiku



Informacione

Prill 2009

Shqipëria paraqet kërkesën zyrtare për anëtarësim në Bashkimin Evropian.

Nëntor 2010

BE miraton vendimin për liberalizimin e vizave me Shqipërinë.

Dhjetor 2010

Hyrja në fuqi e liberalizimit të vizave për qytetarët shqiptarë që udhëtojnë në vendet e zonës Schengen.

Dhjetor 2011

Plani i Punës për anëtarësimin e Shqipërisë në BE, plotësimi i rekomandimeve.

Tetor 2012

Komisioni Evropian rekomandon dhënien e statusit të vendit kandidat për Shqipërinë.

Dhjetor 2013

BE refuzon dhënien e statusit të vendit kandidat për Shqipërinë.

Qershor 2014

Shqipëria merr statusin e vendit kandidat për anëtarësim në Bashkimin Evropian.

Prill 2018

Rekomandim pa kushte për hapjen e negociatave me Shqipërinë.

Mars 2020

Hapja e negociatave për Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut.



Home



Historiku



Informacione